



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, nenin 17 pika 2 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 43 paragrafi 16 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 25.07.2023 shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për anëtar të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Vushtrri

I ftojme të gjitha organizatat joqeveritare përkatësisht shoqërinë civile të Komunës së Vushtrrisë, që të propozojnë nga radhët e tyre një anëtar i cili do të jetë pjesë e komisionit vlerësues për zbatim të procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Vushtrrisë.

Është e preferueshme që kandidati i propozuar të jetë i caktuar nga OJQ-të, përkatësisht grupet e interesit/shoqërisë civile.

Personi i propozuar duhet plotësoj këtë kushte - kriteret:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë
- Të ketë diplomë universitare - e preferuar, drejtimi ekonomik, juridik.
- Të ketë përvojë të punës në fushën e administratës

Propozimit të kandidatit për anëtarë të komisionit vlerësues duhet bashkëngjitur:

- CV e shkurtër
- Kopje e dokumentit të identifikimit
- Kopjen e diplomës universitare
- Dëshminë për përvojën e punës
- Dëshmi për ndjekje të trajnimeve në fushën e administratës

Vendimi për emërim të anëtarit të propozuar në komisionin vlerësues do të merret nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

Afati i fundit për dorëzim të propozimit është data 09.08.2023

Propozimi me shkrim me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohet në zyrën pritëse të Komunës, adresuar zyrës së Kryetarit të Komunës, ose, në E-mail: mirjeta.duraku@rks-gov.net

Propozimet e arritura pas afatit të përcaktuar në këtë thirrje publike nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo sqarim shtesë, mund të kontaktohet çdo ditë pune zyrtari kontaktues i komunës në nr. tel. 044/272577 nga ora 8;30 deri në ora 15;30

